



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Periudha raportuese	Mars, 2016
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Drita Rudi dhe Valbona Gashi

#### 1. PËRMBLEDHJE

*Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.*

#### Kulturë:

- Përgatitja e raportit të punës për DKRS – Sektori i kulturës dhe çështjes gjinore, Bibliotekës, Arkivit, Dodonës dhe QKF-së.

Sa i përket Sektorit të kulturës dhe çështjes gjinore, mbarëvajtja e përgjithshme e punës është realizuar me sukses, si takimet me palë, takime me përgjegjës të kulturës të ambasadave, bashkëpunimi/konsultimet me organizata relevante vendore dhe ndërkombëtare, organizimi i takimeve, pjesëmarrja, planifikimi për aktivitete etj.

Takime me palë lidhur me kërkesat e parashtruara për subvencionim.

Gjatë këtij muaji Arkivi ka vazhduar punën sipas planit të punës, në rregullimin e materialit arkivorë, fondi: Avokatura Publike, si dhe përgjigje në 70 kërkesa të palëve lidhur me dokumentacionin e kërkuar nga ana e tyre.

Në Bibliotekë, në muajin mars 2016, janë realizuar të gjitha detyrat dhe aktivitetet e planifikuara në muajin paraprak. Ka pasur edhe aktivitete të tjera të paplanifikuara, të cilat e kanë ndikuar në rritjen e shërbimeve dhe interesimin e banorëve për bibliotekën dhe leximin.

Për të gjitha aktivitetet e Bibliotekës mund të informoheni në web-faqen në Facebook:

<https://www.facebook.com/Biblioteka-Hivzi-Sylejmani-Prishtin%C3%AB-794156514045919/> dhe në web-faqen e Bibliotekës: [www.biblioteka-pr.org](http://www.biblioteka-pr.org) (është në përpunim e sipër).

Gjatë muajit mars 2016, në teatrin “Dodona” janë zhvilluar një mori aktivitete për realizimin e shfaqjeve të programit të rregullt.

### **Sport dhe Rini:**

- Gjatë muajit mars është shpallur “Thirrja për aplikim” për subvencionim vjetor të klubeve sportive të Komunës së Prishtinës, ku të drejt aplikimi kanë pasur klubet dhe shoqatat sportive publike të regjistruara në regjistrin që mban Sektori i sportit. Shqyrtimi i tyre do të bazohet në plotësimin e kriterëve që janë paraqitur në Thirrje publike, siç janë: klubet/shoqatat, të cilët kanë përmbyllur projektin nga edicioni i kaluar ndaj DKRS-së, klubet/shoqatat, të cilët i janë përgjigjur kërkesës së DKRS-së për plotësimin e Formularit të sportit komunal 2016, si dhe konkurruesit të cilët e kanë dokumentacionin e kompletuar.
- Pasi datës 18 mars, që ka qenë afati i fundit për aplikim, është krijuar databaza e projekt-propozimeve nga klubet/shoqatat sportive që kanë aplikuar, si dhe janë përgatitur materialet për takimin e komisionit, i caktuar për shqyrtimin e këtyre kërkesave, që do të mbahet në javën e parë të muajit prill.
- Gjatë kësaj periudhe raportuese, kemi pranuar kërkesë për regjistrim nga gjithsej pesëmbëdhjetë klube sportive, prej tyre një klub i futsallit dhe 14 (katërmbëdhjetë) klube të notit, të cilat pas kompletimit të dokumenteve nga ana e tyre, bazuar në kriteret mbi regjistrim të klubeve publike sportive, pritet të licencohen nga DKRS-ja.

## **2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA**

### **Kulturë:**

- 18 prilli – Dita e Dëshmorëve të Prishtinës;
- 15 maji – Dita e Familjes;
- 1 qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve;

- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj;
- Huazimi i librit dhe lidhja e gazetave;
- Leximi dhe komentimi i librit;
- Vizatime nga përmbajtja e librit;
- Lojëra logjike, punë dore etj.

Postimi i materialeve dhe aktiviteteve në faqen e bibliotekës në web-faqe dhe Facebook.

Përgatitja e raporteve vjetore për vitin 2015 dhe raporteve mujore të tetarit “Dodona”.

Gjatë muajit mars 2016, janë planifikuar të realizohen disa aktivitete:

Shfaqje të rregullta në skenën e Teatrit të Kukullave;

Shfaqje të rregullta nga skena e mbrëmjes;

Planifikohet realizimi i koncertit të “Korit Gazmor” më 5 mars 2016.

Promovimi i librit të Dea Halimi, si dhe shfaqja e shkurtër “Dita e mësuesit pa mësues” e Refik Gerbeshit, me rastin e Ditës së Mësuesit dhe Ditës së Grave, më 7 dhe 8 mars 2016;

Planifikimi i shfaqjes “#2015”, më 8 mars 2016;

Më 21 mars 2016, realizimi i një shfaqje të teatrit të kukullave me rastin e Ditës Botërore të Teatrove të Kukullave;

Më 28 mars do të jepet shfaqja “#2015” për nder të Ditës Botërore të Teatrit;

Provat e rregullta përkitazi me mbajtjen e nivelit artistik të shfaqjeve të repertorit;

Aktivitete të përditshme për 30-vjetorin e Teatrit dhe Festivalin VI të Teatrove të Kukullave 2016.

### **Sport dhe Rini:**

- 23 prill – Dita e Librit;
- Shqyrtimi i projekteve të klubeve sportive për subvencionim vjetor;
- Thirrja për aplikim për subvencionim të OJQ-ve rinore.

### 3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

*Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë*

#### Kulturë:

- Kontakte me të gjitha institucionet vartëse të DKRS-së për përgatitjen e planifikimit të buxhetit për vitin 2016;
- Vizitë Qendrës Kulturore në Hajvali me Vjosa Rexhepin, ark. dhe Ferdeze Bokshin, inxh. e ndërtimit.  
Qëllimi i vizitës ishte verifikimi i gjendjes ekzistuese të këtij objekti dhe mendimi profesional i marrë nga Vjosa Rexhepi dhe Ferdeze Bokshi.  
Mendimi profesional i zyrtareve mbi gjendjen ekzistuese të këtij objekti, ishte se vlera e renovimit eventual të këtij objekti do të merrte një kosto shumë të lartë në krahasim me një ndërtim të objektit të ri;
- Bashkëpunim me Drejtorinë e Pronës rreth hapësirës së Qendrës së Kulturës në Hajvali. Konsiston se kjo hapësirë është pronë e Xeherores së Plumbit dhe Zinkut në Novobërdë – Kishnicë, me sipërfaqe 4062 m<sup>2</sup>;
- Lajmërim për media rreth vizitës së drejtoreshës së Kulturës, znj. Saranda Bogujevci dhe Ajete Shoshit në degët e bibliotekës “Hivzi Sulejmani” (në fshatra).
- Realizimi i programit festiv për nder të 7- 8 Marsit, Ditës së Gruas dhe Ditës së Mësuesit. Ky aktivitet u organizua së bashku me Drejtorinë e Arsimit, dhe u mbajt në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë. Gjatë programit, Drejtoria e Arsimit, me rastin e 7 Marsit - Ditës së Mësuesit, shpërblen me mirënjohje punëtorët më të dalluar arsimorë, për kontributin e tyre në procesin edukativo-arsimorë, ndërsa së bashku me grupin e grave asambleiste u ndanë mirënjohje gratë veterane të arsimit;
- Inicimi, organizimi dhe realizimi i aktivitetit “Turnament i debatit”, së bashku me organizatën ndërkombëtare “Save the Children”, me rastin e shënimit të 7 marsit - Ditës së Mësuesit, ku u organizua edhe trajnimi i përgjithshëm mbi rregullat dhe teknikat e formatit të debatit “Karl Popper”. Debati kishte karakter garues, ku pjesëmarrës ishin fëmijët e Asamblesë Komunale të Prishtinës, ambasadorët e rinj të Qendrës Kulturore të Fëmijëve, si dhe fëmijët e Grupit “ROR” .  
Debati final u mbajt më 7 mars 2016, në degën “Përkujtimorja” të bibliotekës “Hivzi Sulejmani” në Taukbahçe.

Tema finale e debatit ishte “Mësimdhënësit nuk duhet të kenë të drejtën e grevës”, ku fitues të këtij debati ishin grupi i fëmijëve pjesëmarrës nga Asambleja Komuna e Fëmijëve të Prishtinës.

- Shënimi i “Ditës Ndërkombëtare të Poezisë”, më 21 mars, realizim i organizimit të programit festiv, së bashku me Drejtorinë e Arsimit.

Programi u mbajt në shkollën SHFMU “Model”, ku përveç programit festiv, u bë edhe interpretimi i poezive më të mira të përzgjedhura nga komisioni vlerësues.

- Takim i rregullt dhe informues i Asamblesë Komunale të Fëmijëve të Prishtinës, si dhe diskutimi rreth propozimeve për 15 majin - Ditën e Familjes dhe 1 qershorin - Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve.
- Në Bibliotekë është bërë përpunimi fizik i materialeve bibliotekare:

- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;

- Regjistrimi i anëtarëve të rinj;

- Huazimi i librit dhe lidhja e gazetave;

- Leximi dhe komentimi i librit;

- Vizatime nga përmbajtja e librit;

- Lojëra logjike, punë dore etj.;

- Publikimi i materialeve në faqen e Bibliotekës në Facebook,

- Përgatitja e raporteve vjetore për vitin 2015 dhe raporteve mujore.

- “Press Reader” ( agjenci lajmesh që mbështet dhe është partner i INELI “Balkans-Future Libraies” pjesë e së cilës është Fatime Mehmetaj), në muajin mars dhe prill ka ofruar qasje “online” pa limit dhe pa pagesë në 3 000 gazeta dhe më shumë se 2 000 revista për bibliotekën “Hivzi Sulejmani”. Kjo dhuratë e çmuar për studentët dhe të gjithë të interesuarit është e postuar në faqen e Bibliotekës në Facebook.
- 7 Marsi - Dita e Mësuesit, në bibliotekën "Hivzi Sulejmani" - dega "Përkujtimore" DKRS e Komunës së Prishtinës, në bashkëpunim me “Save the Children”, organizuan debat me karakter garues “Turnament i debatit”, ku pjesëmarrës ishin fëmijët e Asamblesë Komunale të Prishtinës, ambasadorët e QKFP-së, si dhe fëmijët e Grupit ROR. Me këtë rast Biblioteka dhuroi nga një libër për pjesëmarrësit e debatit dhe 3 fituesve anëtarësim pa pagesë për një vit në bibliotekë.
- Trajnim në katalogim të materialeve, me ligjëruesen Rebecca Lubas nga SHBA, në Bibliotekën Kombëtare, mbështetur nga Ambasada e SHBA-së në Kosovë.

Trajnimi është mbajtur më 14 - 25 mars 2016, ku kanë marrë pjesë bibliotekarë me përvojë në katalogim nga Prishtina, Prizreni dhe Ferizaj. Të gjithë pjesëmarrësit janë pajisur me certifikata.

- Në bashkëpunim me Qendrën Korrektuese të Shërbimit Sprovues të Kosovës, në muajin mars kanë kryer punë të obligueshme dy persona: njëri 120 orë, kurse tjetri 20 orë. Ata kanë ndihmuar në përpunimin fizik të librit, bartjen e librave dhe punë të tjera.
- Bashkëpunimi me Këndin Amerikan “Biblioteka Përkujtimore”, ka filluar edhe këtë vit bashkëpunimin me Këndin Amerikan, me qëllim të edukimit joformal, ligjërata në gjuhën angleze dhe nga fusha të tjera, si: teknologjia informative, ekonomia, dizajni etj..
- Kurs për mësimin e shkrim-leximit për gratë e paarsimuara. Ky aktivitet bëhet në bashkëpunim me Këndin Amerikan. Përveç mësimin të shkrim-leximit, ato marrin edhe mësim bazike të teknologjisë.
- Gjatë muajit mars 2016, janë realizuar shfaqje të rregullta në skenën e Teatrit të Kukullave. “Fustani pika-pika”, më 5 mars, “Borëbardha dhe shtatë shkurtabiqët”, më 12 mars, “Rosak pastërtori”, më 15 dhe 18 mars, “Tomi e Xheri”, më 19 mars, “Kësulëkuja”, më 21 mars, “Cirku i lodrave”, më 26 mars 2016.
- Gjatë muajit mars janë realizuar edhe shfaqje të rregullta nga skena e mbrëmjes. “Më fol për dashurinë” është shfaqur repriza tri herë (më 8, 17 dhe 22 mars) nga të cilat më 17 mars është shfaqur në Mitrovicë.
- Është realizuar programi i “Korit Gazmor”, më 5 mars 2016.
- Është realizuar promovimi i librit të Dea Halimit, më 7 mars.
- Është realizuar shfaqja e shkurtër “Dita e mësuesit pa mësues” të Refik Gërbeshit, në kuadër të manifestimeve për nder të festave: Dita e Mësuesit - 7 Mars dhe Dita e Grave - 8 Mars.
- Është realizuar shfaqja “#2015”, më 8 mars 2016.
- Më 21 mars 2016, është realizuar shfaqja ‘Kësulëkuja’ me rastin e Ditës Botërore të Teatrove të Kukullave.
- Më 28 mars, është dhënë shfaqja “#2015” për nder të Ditës Botërore të Teatrit.
- Provat e rregullta përkitazi me mbajtjen e nivelit artistik të shfaqjeve të repertorit realizohen para secilës shfaqje.
- Janë realizuar edhe aktivitete të përditshme për 30-vjetorin e Teatrit dhe Festivalin VI të Teatrove të Kukullave 2016.

## Sport dhe Rini:

- Thirrja për aplikim për subvencionim vjetor të klubeve sportive, ku për periudhën 4 - 18 prill 2016 (periudha e aplikimit nga klubet sportive), kanë aplikuar rreth 90 klube dhe shoqata sportive.
- Pjesëmarrjes në punëtorinë e organizuar nga Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), e mbajtur më 3 mars 2016. Qëllimi i punëtorisë ishte përshkrimi i hollësishëm i projektit “Projekti imagjino një ditë”. Kjo punëtori pati si cak profesionistët e rinjë në përdorimin formave dhe metodave të duhura kulturore të performancës së aplikuar si mënyrë për të nxitur kohezionin social dhe drejtësinë. Qëllimi kryesor i projektit ishte identifikimi i 20 kandidatëve të kualifikuar si trajnerë, të cilët do të jenë pjesë e një grupi me profesionistë të ndryshëm, për të marrë pjesë në trajnimin e trajnerëve dhe projekti të implementohet një kohë të gjatë.

Me anë të këtij projektit “Projekti imagjino një ditë”, u diskutua për mundësitë e përfshirjes dhe fuqizimit të fëmijëve; krentimi i imagjinatës dhe kreativitetit; vendosja e fëmijëve si udhëheqës - tani edhe në të ardhmen; lidhja në shkallë botërore e fëmijëve për të krijuar paqe; bërja e thirrjes për një pikëpamje globale të çështjeve në botë; respektimi i diversitetit dhe komunitetit kulturor; ofrimi i mundësive për bashkëpunim ndërkulturor; promovimi i kulturës si katalizator për ndërmarrësi dhe inovacione; fuqizimi dhe frymëzimi i të rriturve me proceset kreative dhe mjetet për të angazhuar fëmijët në mënyrë aktive.

#### **4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR**

*Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues*

##### **Kulturë:**

- Gjatë muajit mars 2016, në teatrin “Dodona” janë në realizim e sipër tri kukulla, me qëllim të modifikimit të shfaqjes “Peshkatari dhe peshku” (janë duke u realizuar nga Sotiraq Gusho).
- Buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese.

##### **Sport dhe Rini:**

- Para se të prezantohet Projektplani i veprimit rinor lokal 2016-2018 në Bordin e Drejtorëve, respektivisht në Kuvendin e Komunës, me qëllim të miratimit të tij, janë paraqitur disa vërejtje nga drejtoresha Saranda Bogujevci, të cilat do të shqyrtohen me hartuesin e këtij plani në takimet që do të zhvillohen.

## 5. STATISTIKAT

Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës

### Kulturë:

- Edhe në muajin mars ka pasur interesim të madh për anëtarësime të reja në bibliotekë, për huazim të librit dhe për përdorimin e sallave të leximit, si në qendër ashtu edhe në të gjitha degët e bibliotekës.  
Prej 100-150 është numri i atyre që e vizitojnë bibliotekën.

5.1.1. Buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese të vitit 2016.

### Sport dhe Rini:

- Për vitin 2016, për Sektorin e rinisë dhe sportit janë ndarë 250,000 €, ku prej tyre 150,000 € janë planifikuar të shpenzohen për aktivitetet vjetore të klubeve sportive, 50,000 € për projekte të ndryshme sportive, si dhe 50,000 € për subvencione të projekteve rinore.

5.1.2. Takimet me palë.

### Kulturë:

- Takime të vazhdueshme rreth informacioneve për subvencione, raporte, konsultime për kulturë dhe çështje gjinore, si dhe informacione bazuar në nevoja të drejtorisë.
- Në këtë periudhë është mbajtur takim në DKRS me institucionet e tjera kulturore dhe Komisionin për ndarjen e buxhetit për vitin 2016.

### Sport dhe Rini:

- Takime me përfaqësues të klubeve sportive të kryeqytetit, për të diskutuar rreth nevojave dhe kërkesave të ndryshme në fushën e sportit.
- Takime me përfaqësues të OJQ-ve rinore, të cilat u informuan për mënyrën e ndarjes së fondeve gjatë vitit 2016, ku po ashtu u njoftuan për “Thirrjen për aplikim” që do të bëhet në muajin prill për subvencionim të OJQ-ve të ndryshme rinore.



- Takim me përfaqësuesit e OJQ-ve rinore lidhur me planifikime të aktivitete të ndryshme rinore, po ashtu asistencë në realizime të projekteve rinore, si p.sh. ofrim i hapësirës për mbajtjen e aktivitete- debateve për OJQ-në “Kosovo Social Club”.
- Sektori i Rinisë dhe Sportit mbështet çdo iniciativë të të rinjve të kryeqytetit, duke u bazuar gjithnjë në politikat programore të Sektorit dhe mundësitë buxhetore që ka ky sektor.

### **Takimet me institucionet e tjera**

#### **Kulturë:**

- Gjatë muajit mars janë mbajtur dy takime të Grupit punues për projektin SoRi, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës së Prishtinës dhe organizatës “Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit” (GIZ) GmbH. Takimi i parë ishte informues, ndërsa në takimin e dytë u diskutua për grupet e pafavorizuara nga fusha për të cilën e përfaqësojmë, me qëllim të identifikimit të grupit vulnerabel dhe të ndërmarrim aktivitete për identifikim, arritjen dhe qasjen tek ky grup, ku jemi fokusuar në dy objektiva, gjithashtu sipas sugjerimeve nga zyrtarët e GIZ, që për fillim t’i kemi me pak grupe vulnerabel.
  - Fëmijët në situatë rruge ( ku e kemi parasysh që ka fëmijë nga të gjitha komunitete etnik dhe të aftësive të kufizuara);
  - Sigurimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara.
- Pjesëmarrje në takimin e zyrtarëve të certifikuar për performancën komunale, me Berat Abdiun nga UBO “Consulting”, si dhe z. Muhedin Nushi, drejtor i Drejtorisë së Administratës, lidhur me informimin e ndryshimit të tabelave plotësuese për performancë, që planifikohet të zbatohet prej vitit 2017.
- Konsultime të vazhdueshme me institucionet vartëse të DKRS-së lidhur me planifikimin e organizimit për 7 Marsin dhe 8 Marsin.
- Takime dhe konsultime të vazhdueshme me “Save the Children” znj. Rebeka Qena, rreth organizimit të aktivitetit “Turnament i debatit” për festën 7 Marsi – Dita e Mësuesit.

#### **5.1.3. Diskutime publike/takimet me qytetarë**

#### **Sport dhe Rini:**

- Takime me përfaqësues të bashkësive lokale, të cilët në bazë të kërkesës së banorëve të lagjeve të tyre, kërkojnë ndërtim të hapësirave rekreative sportive, me qëllim të krijimit të kushteve infrastrukturore, rekreative, sportive më të mira për të rinjtë e tyre.

#### **5.1.4. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare.**

### 5.1.5. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

#### Kulturë:

- Pranimi i raporteve të lëndëve të subvencionuara të fazave paraprake.
- Njoftimi me shkrim i palëve për kërkesat e subvencionuara, njoftimi për refuzime dhe të aprovuara.

#### Sport dhe Rini:

- Në sektorin tonë gjatë muajit shkurt janë pranuar gjithsej 51 lëndë, ku 49 kërkesa janë nga klubet dhe shoqatat sportive, ndërsa 2 janë nga OJQ-të rinore.

### 5.1.6. Takime të tjera

#### Kulturë:

- Pjesëmarrje në punëtorinë e organizuar nga Misioni i OSBE së në Kosovë "Një ditë e imagjinuar", të ftuara nga Komuna ishin Drita Rudi dhe Mevlude Zejnullahu.
- Takime të rregullta pune në kuadër të aktiviteteve të shumta të Teatrit.

## 6. SFIDAT

*Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.*

#### Kulturë:

- Sfida më e madhe në Bibliotekë, e cila na përcjellë me vite dhe po ndikon në realizimin e objektivave tona, është hapësira e pamjaftueshme për vendosjen e librave të ri të cilët do të shfrytëzoheshin nga lexuesit, mungesa e hapësirës në salla të leximit për studentë, mungesa e hapësirës për shërbime të reja inovative në bibliotekë, ku do të inkuadrohej komuniteti dhe do të rritej interesimi për librin dhe leximin, që biblioteka të jetë qendër kulturore e komunitetit për mësim gjatë gjithë jetës.

Telefonatat dhe mesazhet në faqen tonë në Facebook rreth hapjes së objektit të ri dhe ankesat për kushtet e vështira dhe mungesës së vendeve për studim nuk kanë të ndalur.

Në teatrin "Dodona" sfidat janë të shumta, sepse kemi nevojë për mjete, që ta shtojmë prodhimin me shfaqje të reja, rikthimin e shfaqjeve të vjetra të suksesshme, si dhe mbështetjen e udhëtimeve që shfaqjet tona, që kanë vlerë, si për fëmijë ashtu edhe për të rritur.

## 7. REKOMANDIME

*Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë, etj.*

### Kulturë:

- Angazhim maksimal për fillimin e punës në objektin e ri.
- Trajnime të stafit të bibliotekës për organizimin e fondit dhe hapësirave në objektin e ri dhe njohuri për shërbime të reja.

## 8. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

### Kulturë:

- Organizimi i manifestimit për nder të 18 Prillit – Ditës së Dëshmorëve të Prishtinës.
- Dita Ndërkombëtare e Librit për Fëmijë e të Rinj (2 prill);  
Aktiviteti realizohet nga Biblioteka, me mbështetjen e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;  
Do të bëhet prezantimi i shkrimtarit të njohur Rexhep Hoxha;
- Shpallja e rezultateve të Konkursit letrar 2016 dhe leximi i mesazhit që këtë vit vjen nga Brazili;
- Java e Bibliotekës në Kosovë (Biblioteka Kombëtare), ngjarja më me rëndësi e bibliotekave, ku do të ketë tema profesionale nga bibliotekaria, ekspozita të librit, donacione etj.;  
Në kuadër të kësaj jave, Fatime Mehmetaj do të prezantojë programin INELI BALKANS - Future Library;
- Dita Ndërkombëtare e Librit dhe të Drejtave të Autorit (23 prill 2016);  
Në bashkëpunim me OJQ “Artpolis”, “Etea” dhe Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Biblioteka do të bëjë anëtarësim pa pagesë në sheshin “Nënë Tereza”, do t’i ndihmojë OJQ-të me libra;
- Përmirësimi e dizajnit të web-faqes së Bibliotekës <http://www.biblioteka-pr.org/>;
- Aktivitete të përjavshme, në bashkëpunim me Këndin Amerikan në degën “Përkujtimore”;  
Aktivitete me fëmijë: komentim i librit, vizatime dhe punë dore në degën “Përrallat”;
- Në teatrin “Dodona” gjatë muajit prill 2016 planifikohen të realizohen disa aktivitete;
- Shfaqje të rregullta në skenën e Teatrit të Kukullave;  
Shfaqje të rregullta nga skena e mbrëmjes;

Provat e rregullta të shfaqjeve të repertorit, me qëllim të ruajtjes së nivelit artistik dhe teknik të shfaqjeve;

- Aktivitete të përditshme për 30-vjetorin e Teatrit dhe Festivalin VI të Teatrove të Kukullave 2016;
- Planifikohen biseda dhe takime për aranzhimin e realizimit të një turneu disa ditor në Tiranë, për realizimin e tri shfaqjeve të skenës së mbrëmjes në formë shkëmbimi kulturor.

### **Sport dhe Rini:**

- Turneu memorial i shahut “Mesut Gashi”, organizuar nga klubi i shahut “Prishtina” dhe i mbështetur financiarisht nga DKRS, turne ky i cili mbahet nën patronatin e Komunës së Prishtinës. Turneu mbahet më 3 prill 2016.
- Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimi ndërmjet Forumit për Iniciativë Qytetare (FIQ) dhe Komunës së Prishtinës, për projektin “Ambasadorët e rinj”, është planifikuar të bëhet në muajin prill 2016.  
Forumi për Iniciativa Qytetare FIQ, me financim nga National Endowment for Democracy NED, ka filluar implementimin e projektit “Ambasadorët e rinj”, projekt ky i cili ka për synim të zhvillojë dhe të forcojë aktivizimin rinor. Me aktivitetet e parapara që konsistojnë në krijimin e grupeve joformale rinore, FIQ do të punojë ngushtë me të rinjtë e Prishtinës, duke iu dhënë atyre pronësinë në vendimmarrje gjatë realizimit të projektit. Në këtë rast, Komuna e Prishtinës do të ofron përkrahje financiare në vlerë prej 2,000 € shtesë, të cilat barten të FIQ si bartës i projektit.

### **9. TË TJERA**

*Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme*

### **Kulturë:**

REKAPITULIM: Në teatrin “Dodona” gjatë muajit mars 2016, janë realizuar **23 programe** të ndryshme (për fëmijë, për të rritur dhe programe mysafire).